

VENDIM
Nr.20, datë 9.1.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE, TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË
SARANDË TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridikisionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.411, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Sarandë”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-15	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
20-26,28,33-35	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
36-41	Varrezat publike	Në pronësi
42-46,128-177,228-299	Infrastruktura (rrugë vendore, lulishte,) dhe shërbime publike.	Në pronësi
47-127	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në Pronësi
178-184,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në Pronësi
200,207,209,211,212,213, 216,217	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
313-316,318	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
317,368	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo productive,dhe kullota)	Në pronësi
339-351	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
227	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimeve sociale.	Në pronësi